

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**  
**NDËRMJET**  
**MINISTRISË SË KULTURËS TË**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE**  
**MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT TË**  
**REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është arritur ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, nga ana tjetër.

Këtu e më poshtë tekstit, referuar si "Palët".

**DUKE MARRË NË KONSIDERATË** ndërgjegjësimit mbi rëndësinë dhe nevojën për të siguruar mbrojtjen e duhur ligjore për të drejtën e autorit dhe zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës së autorit, njohjen e avantazhit të bashkëpunimit bilateral, e si rrjedhojë, duke patur dëshirën për të përforcuar këtë aktivitet në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit, njohjen e rëndësisë së bashkëpunimit në fushën e të drejtës së autorit për zhvillimin ekonomik dhe social për të dyja vendet, vullnetin për të shkëmbyer informacion dhe eksperiencë si dhe për të promovuar marrëdhënie miqësore ndërmjet tyre, palët kanë rënë dakord sa më poshtë:

## **Neni 1**

### **Fusha e bashkëpunimit**

Palët do të kontribuojnë në zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e të drejtës së autorit, dhe ato me interes të përbashkët për përfitime të barabarta dhe reciproke, në përputhje me dispozitat e këtij Memorandumi dhe legjislacionin në fuqi në të dy shtetet.

## **Neni 2**

### **Aktivitetet dypalëshe**

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të kryhet në fushat kryesore, si më poshtë:

- a) Shkëmbimi i praktikave më të mira në aktivitetet e tyre të zakonshme;
- b) Organizimi i vizitave të studimit ashtu siç bien dakord financiarisht palët;
- c) Shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave në ofrimin e shërbimeve të specializuara për të drejtat e autorit për qytetarët;
- d) Shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave në aktivitetet e rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e autorit;
- e) Organizimi i konferencave, simpoziumeve, seminareve dhe eventeve tjera edukative në lidhje me të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura apo të përfaqësuara.

Aktivitetet bashkëpunuese do të jepen me më shumë detaje në programin e Bashkëpunimit, i cili do të përgatitet me miratimin e Palëve.

## **Neni 3**

### **Pjesëmarrja e palëve të treta**

Palët, me miratim reciprok, mund të kërkojnë pjesëmarrjen e palëve të treta për financim dhe implementim të programeve dhe projekteve, të cilat do të kryhen si forma bashkëpunimi brenda kuadrit të këtij Memorandumi.

Palët do të mbështesin pjesëmarrjen e organizatave kërkimore dhe të zhvillimit, sipërmarrjet dhe aktorë të tjerë nga të dy shtetet, në projekte dhe programe bilaterale dhe multilaterale në lidhje me të drejtat e Autorit.

#### **Neni 4**

### **Raporti i Memorandum i Bashkëpunimit me të drejtat dhe detyrimet nga marrëveshjet tjera të palëve**

Dispozitat e këtij Memorandumi, në asnjë mënyrë nuk do të ndikojnë të drejtat dhe detyrimet e Palëve të cilat burojnë nga marrëveshje bilaterale dhe multilaterale, qoftë ato ekzistuese apo në të ardhmen, në të cilat ato janë Palë apo nënshkruese.

#### **Neni 5**

### **Zbatimi i Memorandum i Bashkëpunimit**

Palët akordohen që këtë memorandum do ta zbatojnë Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Zyra për Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 6**

### **Gjuha zyrtare e korrespondencës**

E gjithë korrespondenca do të kryhet në gjuhën shqipe.

#### **Neni 7**

### **Kohëzgjatja e Memorandum i Bashkëpunimit**

Memorandumi i bashkëpunimit do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi për pesë vjet. Ai do të zgjerohet automatikisht për të njëjtin afat me përjashtim nëse njëra nga Palët dorëzon një njoftim me shkrim të Pala tjetër, të paktën gjashtë muaj përpara datës së planifikuar të përfundimit, duke deklaruar qëllimin e saj për ta përfunduar atë.

#### **Neni 8**

### **Amendimi i Memorandum i Bashkëpunimit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Memorandumi i bashkëpunimit mund të amendohet me miratim reciprok të Palëve. Çdo modifikim duhet të formatizohet me shkrim, të përfshijë datat kur modifikimet bëhen efektive dhe pas shkëmbimit përmes kanaleve diplomatike do të formojë pjesë integrale e memorandumit.

Të gjitha çështjet apo mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Memorandumit duhet të zgjidhen me marrëveshje reciproke.

Me përjashtim nëse Palët bien dakord ndryshe, ndërprerja e parakohshme e Memorandumit nuk duhet të pengojë ndonjë projekt apo aktivitet në vazhdim.

Bërë në Korçë, më 27. 11. 2017, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të dy tekstet njëlloj të vlefshëm.

**PËR MINISTRINË E KULTURËS  
TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**PËR MINISTRINË E KULTURËS,  
RINISË DHE SPORTIT TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

MIRELA KUMBARO  
MINISTËR

KUJTIM GASHI  
MINISTËR